



USAID

NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

Drejtësia Vlen mbanë Punëtori për Fuqizimin Operacional të Agjencisë për Ndhmë Juridike Falas

Më 23 gusht 2018, Aktiviteti i USAID-it Drejtësia Vlen në bashkëpunim me Agjencinë për Ndhmë Juridike Falas (ANJF) organizuan Punëtorinë e Dytë për Fuqizimin Operacional të ANJF-së, për të përmirësuar efikasitetin e zyrave rajonale. E dizajnuar për të promovuar dhe fuqizuar përdorimin e praktikave më të mira për zgjidhjen e problemeve, Punëtorja Mujore për Fuqizimin Operacional ishte e para në një seri të takimeve të rregullta mujore mes lidershit të ANJF-së dhe ekspertëve të Aktivitetit Drejtësia Vlen.

E udhëhequr nga Drejtoresha e Departamentit Ligjor të ANJF-së, Anita Kalanderi, dhe Këshilltarit të Lartë Strategjik të Drejtësia Vlen Harold D. Dampier Jr., pjesëmarrësit, duke përfshirë 22 zyrtarëve ligjorë të zyrave rajonale të ANJF-së, u inkurajuan të identifikojnë problemet dhe zgjidhet e mundshme të zyrave rajonale, që do të përmirësonte funksionimin e përgjithshëm të ANJF-së dhe zyrave rajonale.

Aktiviteti Drejtësia Vlen është projekt tre-vjeçar i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) për të përmirësuar qasjen në drejtësi për të gjithë, përfshirjen e grupeve të marginalizuara dhe në disavantazh përmes fuqizimit të institucioneve, aktorëve dhe proceseve për ofrimin e ndihmës juridike, shërbimeve dhe informatave.